5. Një vektor AAV që përfshin polinukleotidin e pretendimit 4.

6. Një qelizë pritëse që përfshin një ose më shumë proteina me gisht zinku të pretendimit 1, një ose më shumë proteina shkrirjeje të pretendimit 2 ose 3, një ose më shumë polinukleotide të pretendimit 4 dhe/ose një ose më shumë vektorë AAV të pretendimit 5.
  7. Një përbërje farmaceutike që përmban një ose më shumë polinukleotide sipas pretendimit 4 dhe/ose një ose më shumë vektorë AAV sipas pretendimit 5.
  8. Një metodë për modifikimin e shprehjes së një geni Htt në një qelizë, që përfshin administrimin në qelizë të një ose më shumë polinukleotideve sipas pretendimit 4, një ose më shumë vektorëve AAV sipas pretendimit 5 dhe/ose një ose më shumë përbërjeve farmaceutike sipas pretendimit 7, ku metoda kryhet ex vivo ose in vitro.
  9. Metoda e pretendimit 8, ku geni Htt përfshin të paktën një alel të tipit të egër dhe/ose një alel mutant.
  10. Metoda e pretendimit 8 ose 9, ku një ose më shumë polinukleotide dhe një ose më shumë vektorë AAV kodifikojnë proteinën e shkrirjes dhe ku proteina e shkrirjes përfshin një domen represimi dhe shprehja e genit Htt është e shtypur.
  11. Metoda e çdonjërit prej pretendimeve 8 deri në 10, ku qeliza është një qelizë neuronale.
  12. Polinukleotidi sipas pretendimit 4, vektori AAV sipas pretendimit 5, dhe/ose përbërja farmaceutike sipas pretendimit 7, për përdorim në një metodë për trajtimin dhe/ose parandalimin e Sëmundjes së Huntingtonit (HD) tek një subjekt që ka nevojë për të, ku metoda përfshin administrimin tek subjekti të një ose më shumë prej polinukleotideve, vektorëve AAV dhe/ose përbërjeve farmaceutike të lartpërmendura, ku domeni funksional është një domen represion transkriptues.
  13. Polinukleotidi, vektori AAV dhe/ose përbërja farmaceutike për përdorim sipas pretendimit 12, ku administrimi bëhet në një qelizë neuronale në trurin e subjektit.
  14. Polinukleotidi, vektori AAV dhe/ose përbërja farmaceutike për përdorim sipas pretendimit 13, ku qeliza neuronale është në striatum.
-

(11) **13110**

(97) EP4464721//11.06.2025

(96) 24203287.8//05.10.2020

(22) 16.06.2025

(21) [AL/P/2025/296](#)

(54) **KOMPLEKSE PEPTIDI BICIKLIK HETEROTANDEM**

29.09.2025

(30) US 201962910129 P 03/10/2019

(71) BicycleTX Limited/ Blocks A&B Portway Building Granta Park, Great Abington  
Cambridge, Cambridgeshire CB21 6GS / GB,

(72) MCDONNELL, Kevin/Cambridge, CB21 6GS / GB,

MUDD, Gemma/Cambridge, CB21 6GS / GB,

UPADHYAYA, Punit/Cambridge, CB21 6GS / GB,

(74) Arben Kryeziu//IDRIZ DOLLAKU; Nd. 3; H. 2; Ap. 19; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1; NJËSIA BASHKIAKE NR. 1; 1004; TIRANË.

(57) 1. Ligand peptidik i cili lidhet me Nectin-4 e pranishme tek një qelizë kanceroze, që përfshin një polipeptid i cili përfshin të paktën tre grupe reaktive, të ndara nga të paktën dy sekuenca lidhëse , dhe një mbajtëse molekulare që formon lidhje kovalente me grupet reaktive të polipeptidit në mënyrë të tillë që të formohen të paktën dy lidhje polipeptidike në mbajtësen molekulare, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij; karakterizuar në atë që polipeptidi lartpërmendur është një derivat i modifikuar i CP[1Nal][dD]CM[HArg]DWSTP[HyP]WC; ku një ose më shumë mbetje të cisteinës zëvendësohen me një grup reaktiv i përzgjedhur nga acidi 3-merkaptopropionik, cisteamina dhe penicillamina; ku 1Nal përfaqëson 1-naftilalaninën, HArg përfaqëson homoargininën dhe HyP përfaqëson hidroksiprolinën.

2. Ligandi peptidik i pretendimit 1, ku mbajtësja molekulare është 1,1',1'-(1,3,5-triazinane-1,3,5-triyl) triprop-2-en-1-one (TATA) .

3. Kompleks peptidik që përfshin: (a) një ligand të parë peptidik i cili lidhet me Nectin-4 të pranishme në një qelizë kanceroze; i lidhur nëpërmjet një lidhësi me (b) një peptid të dytë; ku peptidi i parë përfshin një polipeptid që përfshin të paktën tre grupe reaktive, të ndara nga të paktën dy sekuenca lidhëse dhe një mbajtëse molekulare që formon lidhje kovalente me grupet reaktive të polipeptidit në mënyrë të tillë që të formohen të paktën dy lidhje polipeptidike në mbajtësen molekulare , ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij; karakterizuar në atë që polipeptidi në fjalë i ligandit të parë peptidik në fjalë është një derivat i modifikuar i CP[1Nal][dD]CM[HArg]DWSTP[HyP]WC; ku një ose më shumë mbetje të cisteinës zëvendësohen me një grup reaktiv të përzgjedhur nga acidi 3-merkaptopropionik, cisteamina dhe penicillamina; ku 1Nal përfaqëson 1-naftilalaninën, HArg përfaqëson homoargininën dhe HyP përfaqëson hidroksiprolinën.

4. Kompleksi peptidik i pretendimit 3, ku mbajtësja molekulare është 1,1',1'-(1,3,5-triazinane-1,3,5-triyl) triprop-2-en-1-one (TATA) .

(11) **13119**

(97) EP3917521//28.05.2025

(96) 20747738.1//30.01.2020

(22) 17.06.2025

(21) [AL/P/2025/298](#)

(54) **FORMA TË NGURTA TË NJË PROMOTORI TË SPINOGENEZËS**

07.10.2025

(30) US 201962799644 P 31/01/2019

(71) Spinogenix, Inc./ 4225 Executive Square, Suite 600, La Jolla, CA 92037 / US,

(72) Stella T. SARRAF/c/o Spinogenix, Inc. 9620 Towne Centre Drive 100 San Diego, California 92121 / US,

Elizabeth Büchler VADAS/c/o Spinogenix, Inc. 9620 Towne Centre Drive 100 San Diego, California 92121 / US

(74) Krenar Loloçi//ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Kristalina 2-(2-(2-(2-(4-(benzo[d]tiazol-2-il) fenoksi) etoksi) etoksi) etoksi) etan-1-ol (Përbërja I Forma I) e karakterizuar nga një difraktogram pluhuri me rreze X që përfshin kulmet e mëposhtme ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) : 4.6, 20.8, dhe 23.7 siç përcaktohet në një difraktometër duke përdorur rrezatimin Cu-K $\alpha$  në një gjatësi vale prej 1.5406 Å, ku difraktogrami opsionalisht më tej përfshin kulmet ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) në 9.2, 16.3, 18.6, dhe 19.6.

2. Përbërja I Forma I sipas pretendimit 1, e karakterizuar nga një kurbë kalorimetrie skanuese diferenciale (DSC) që përfshin një endotermë në  $70^\circ\text{C} \pm 2^\circ\text{C}$ .

3. Kristalina 2-(2-(2-(2-(4-(benzo[d]tiazol-2-il) fenoksi) etoksi) etoksi) etoksi) etan-1-ol (Përbërja I Forma II) e karakterizuar nga një difraktogram pluhuri me rreze X që përfshin kulmet e mëposhtme ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) : 9.2, 13.8, dhe 16.1, siç përcaktohet në një difraktometër duke përdorur rrezatimin Cu-K $\alpha$  në një gjatësi vale prej 1.5406 Å, ku difraktogrami opsionalisht më tej përfshin kulmet ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) në 6.9, 11.5, dhe 18.4.

4. Kristalina 2-(2-(2-(2-(4-(benzo[d]tiazol-2-il) fenoksi) etoksi) etoksi) etoksi) etan-1-ol (Përbërja I Forma III) e karakterizuar nga një difraktogram pluhuri me rreze X që përfshin kulmet e mëposhtme ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) : 7.7, 10.3, dhe 15.3, siç përcaktohet në një difraktometër duke përdorur rrezatimin Cu-K $\alpha$  në një gjatësi vale prej 1.5406 Å, ku difraktogrami opsionalisht më tej përfshin kulmet ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) në 5.1, 12.8, dhe 18.0.

5. Kristalina 2-(2-(2-(2-(4-(benzo[d]tiazol-2-il) fenoksi) etoksi) etoksi) etoksi) etan-1-ol (Përbërja I Forma IV) e karakterizuar nga një difraktogram pluhuri me rreze X që përfshin kulmet e mëposhtme ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) : 5.4, 22.4, dhe 23.3, siç përcaktohet në një difraktometër duke përdorur rrezatimin Cu-K $\alpha$  në një gjatësi vale prej 1.5406 Å, ku difraktogrami opsionalisht më tej përfshin kulmet ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) në 10.8, 18.9, 23.9, dhe 26.8.

6. Përbërja I Forma IV sipas pretendimit 5, e karakterizuar nga një kurbë kalorimetrie skanuese diferenciale (DSC) që përfshin një endotermë në  $48^\circ\text{C} \pm 2^\circ\text{C}$  dhe një endotermë në  $59^\circ\text{C} \pm 2^\circ\text{C}$ .

7. Kristalina 2-(2-(2-(2-(4-(benzo[d]tiazol-2-il) fenoksi) etoksi) etoksi) etoksi) etan-1-ol (Përbërja I Forma V) e karakterizuar nga një difraktogram pluhuri me rreze X që përfshin kulmet e mëposhtme ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) : 4.6, 9.2, dhe 23.1, siç përcaktohet në një difraktometër duke përdorur rrezatimin Cu-K $\alpha$  në një gjatësi vale prej 1.5406 Å, ku difraktogrami opsionalisht më tej përfshin një kulm ( $2\theta \pm 0.2^\circ$ ) në 13.8 dhe 18.6.


8. Përbërja I Forma V sipas pretendimit 7, e karakterizuar nga një kurbë kalorimetrie skanuese

diferenciale (DSC) që përfshin një endotermë në  $70\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 2\text{ }^{\circ}\text{C}$ .

9. Një kompozim farmaceutik që përfshin një ose më shumë forma kristalore të ndonjërit prej pretendimeve të mëparshme dhe një ose më shumë mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.


10. Forma kristalore e Përbërjes I sipas ndonjërit prej pretendimeve 1-8, ose kompozimi farmaceutik i pretendimit 9, për përdorim në një metodë të promovimit të spinogjenezës në një pacient, metoda që përfshin administrimin e një sasive terapeutikisht efektive të një forme të Përbërjes I të ndonjërit prej pretendimeve 1-8 ose një kompozim farmaceutik të pretendimit 9, ku pacienti opsionalisht vuan nga një sëmundje neuronale, ku sëmundja neuronale është opsionalisht e zgjedhur nga sëmundja e Alzheimerit, sëmundja e Parkinsonit, demenca e Parkinsonit, autizmi, sindroma e brishtë X, dhe dëmtimi traumatik i trurit, dhe veçanërisht është sëmundja e Alzheimerit.

11. Një proces për përgatitjen e Përbërjes I, ose një kripe farmaceutikisht të pranueshme të saj:



Përbërja I

që përfshin kontaktin e Përbërjes A me Përbërjen B për të formuar Përbërjen I:



Përbërja A


Përbërja B

në kushtet e reaksionit të parë që përfshin një halid,

ku halidi opsionalisht është një halid metali alkaline, opsionalisht është një jodur metali alkaline, dhe veçanërisht është jodur kaliumi.

12. Procesi i pretendimit 11, ku kushtet e reaksionit të parë më tej përfshijnë një bazë inorganike, veçanërisht karbonat kaliumi, dhe ku kushtet e reaksionit të parë opsionalisht përfshijnë një temperaturë prej 65 deri në  $120\text{ }^{\circ}\text{C}$ .

13. Procesi i pretendimit 11, më tej që përfshin kontaktin e Përbërjes C me Përbërjen D për të formuar Përbërjen A:



Përbërja C


Përbërja D

në kushtet e reaksionit të dytë që përfshin një acid protik,

ku acidi protik është opsionalisht një acid organik, dhe opsionalisht është acid acetik, dhe ku acidi protik opsionalisht tret Përbërjen C dhe Përbërjen D.

14. Procesi i pretendimit 13, ku acidi protik është i pranishëm në një raport molar stekiometrik më të madh krahasuar me të dyja Përbërjen C dhe Përbërjen D.

15. Procesi i pretendimit 13, më tej që përfshin kontaktimin e Përbërjes E me p-toluensulfonil klorid për të formuar Përbërjen B:



#### Përbërja E

në kushtet e reaksionit të tretë që përfshin një kripë argjendi,  
ku kripa e argjendit opsionalisht është Ag<sub>2</sub>O, dhe  
ku kushtet e reaksionit të tretë opsionalisht më tej përfshijnë një jodur metali alkaline.

(11) **13115**

(97) EP3740282//26.03.2025

(96) 19703874.8//17.01.2019

(22) 23.06.2025

(21) [AL/P/2025/304](#)

(54) **FRENUES TË METALOTIONEINËS PËR TRAJTIMIN E DIABETIT, HEPATITIT, DHE/OSE SËMUNDJES INFLAMATORE TË MËLÇISË**

03.10.2025

(30) US 201862618332 P 17/01/2018

(71) University of Connecticut/ 262 Farmington Avenue, Farmington, CT 06030-6400 / US, ;  
Joslin Diabetes Center, Inc./ One Joslin Place, Boston, MA 02215 / US, //

(72) Michael, A. LYNES/c/o University of Connecticut 262 Farmington Avenue  
Farmington, CT 06030-6400 / US,

Yu-Hua TSENG/c/o Joslin Diabetes Center, Inc. One Joslin Place Boston, MA 02215 / US,

Matthew, D. LYNES/c/o Joslin Diabetes Center, Inc. One Joslin Place Boston, MA 02215 / US,

(74) Krenar Loloçi//ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5;  
NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një kompozim që përfshin një frenues të metalotioneinës jashtëqelizore njerëzore (MT) për përdorim në trajtimin ose limitimin e zhvillimit të një çrregullimi të zgjedhur nga grupi i përbërë prej diabet të tipit 2, hepatiti i shkaktuar nga përdorimi i rëndë i alkoolit, medikamente, toksina ose steatohepatiti jo-alkoolik (NASH), dhe sëmundja inflamatore e mëlçisë, ku përdorimi përfshin administrimin të një subjekti me çrregullimin ose në rrezik të çrregullimit të një sasie terapeutikisht efektive të kompozimit për të trajtuar ose limituar zhvillimin e çrregullimit, ku frenuesi i MT jashtëqelizore njerëzore përfshin një antitrop anti-MT ose një fragment i tij që lidhet me antigenin dhe/ose një aptamer i cili lidhet specifikisht të MT jashtëqelizore njerëzore.

2. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku subjekti ka diabet të tipit 2 ose është në rrezik të zhvillimit të diabetit të tipit 2, dhe përdorimi shërben për të trajtuar ose limituar zhvillimin e diabetit të tipit 2.

3. Kompozimi për përdorim i pretendimit 2, ku subjekti është në rrezik të diabetit të tipit 2, dhe përdorimi shërben për të limituar zhvillimin e diabetit të tipit 2 në subjekt.

4. Kompozimi për përdorim i pretendimit 2, ku subjekti ka diabet të tipit 2, dhe metoda shërben për të trajtuar diabetin e tipit 2 në subjekt.

5. Kompozimi për përdorim i pretendimit 4, ku trajtimi përfshin limitimin e një ose më shumë prej komplikimeve diabetike të tipit 2, të zgjedhura nga grupi i përbërë prej hiperglicemisë, hipoglicemisë, rezistencës ndaj insulinës, nefropatisë diabetike, neuropatisë diabetike, retinopatisë diabetike, proteinurisë, pastrimit glomerular të dëmtuar, çrregullimeve të qarkullimit të gjakut nga diabeti, mosfunksionimit të veshkave, sëmundjes kardiovaskulare, poliurisë, polidipsisë, humbjes në peshë, goditjes në tru, dhe reduktimit të frekuencës së nevojës për insulinë ose terapi të tjera.

6. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku subjekti ka hepatit të shkaktuar nga përdorimi i rëndë i alkoolit, medikamente, toksina ose steatohepatiti jo-alkoolik (NASH) , dhe përdorimi shërben për të trajtuar hepatitin në subjekt.
  7. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1 ose 6, ku subjekti ka hepatit të shkaktuar nga steatohepatiti jo-alkoolik (NASH) , dhe përdorimi shërben për të trajtuar hepatitin në subjekt.
  8. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku subjekti ka një sëmundje inflamatore të mëlçisë, dhe metoda shërben për të trajtuar sëmundjen inflamatore të mëlçisë në subjekt.
  9. Kompozimi për përdorim i pretendimit 8, ku sëmundja inflamatore e mëlçisë është zgjedhur nga grupi i përbërë prej steatohepatitit joalkoolik (NASH) dhe/ose sëmundjes së mëlçisë yndyrore joalkoolike (NAFLD) .
  10. Kompozimi për përdorim i pretendimit 8 ose 9, ku sëmundja inflamatore e mëlçisë është steatohepatiti joalkoolik (NASH) .
  11. Kompozimi për përdorim i pretendimit 8 ose 9, ku sëmundja inflamatore e mëlçisë është sëmundja e mëlçisë yndyrore jo-alkoolike (NAFLD) .
  12. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1-11, ku frenuesi i MT jashtëqelizore njerëzore përfshin një antitrop anti-MT ose një fragment të tij që lidhet me antigjenin.
  13. Kompozimi për përdorim i pretendimit 12, ku antitropi anti-MT ose një fragment i tij që lidhet me antigjenin përfshin një antitrop monoklonal ose një fragment të tij që lidhet me antigjenin.
  14. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 12-13, ku antitropi anti-MT përfshin një antitrop anti-MT të humanizuar, ose një fragment të tij që lidhet me antigjenin.
  15. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1-14, ku frenuesi i MT jashtëqelizore njerëzore është lidhur te pjesa që synon qelizat pankreatike ose hepatike.
-

(11) **13086**

(97) EP3899071//30.04.2025

(96) 19900677.6//03.12.2019

(22) 25.06.2025

(21) [AL/P/2025/312](#)

(54) **PROCESI I RICIKLIMIT TË BATERISË**

18.09.2025

(30) AU 2018904918 21/12/2018 ,EP 19161012 06/03/2019

(71) A.C.N. 630 589 507 PTY LTD/ Level 3, 1292 Hay Street West Perth, Western Australia 6005 / AU

(72) BEER, Gavin/16 Rowan Place WOODLANDS, Western Australia 6018 / AU,  
URBANI, Mark Daniel/6 Acastus Road WATTLE GROVE, Western Australia 6107 / AU,

(74) Aleksandra Meçaj//Myslym Shyri; Nd. 0; ; ; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË.

(57) 1. Metodë për rikuperimin e metaleve nga një rrjedhë ushqyese që përmban një ose më shumë metale me vlerë dhe litium, metoda përfshin: nënshtrimin e rrjedhës ushqyese ndaj një shpëlarjeje me acid sulfurik për të formuar një lëng që përmban një tretësirë shpëlarjeje të kripërave të metaleve të tretshme dhe një mbetje të ngurtë; ndarjen e tretësirës së shpëlarjes së mbushur dhe mbetjes së ngurtë; nënshtrimin e tretësirës së shpëlarjes së mbushur në një hap precipitimi për të hequr hekurin dhe aluminin, hapi i precipitimit përfshin shtimin e amoniakut për të rritur pH-in e tretësirës së shpëlarjes në mbi 4.5; nënshtrimin e tretësirës së shpëlarjes së mbushur në një ose më shumë hapa të veçantë nxjerrjeje me tretës, ku çdo hap nxjerrjeje me tretës rikuperon një ose më shumë metale me vlerë nga tretësira e shpëlarjes së mbushur dhe ku çdo hap nxjerrjeje me tretës përfshin dozimin e tretësirës së shpëlarjes së mbushur me amoniak për të ruajtur një pH të synuar, tretësira e mbetur e shpëlarjes së mbushur përfshin rikuperimin e litiumit nga litiumi nga tretësira e shpëlarjes së mbushur; dhe pas hapat të rikuperimit të litiumit, tretësira e shpëlarjes i nënshtrohet një hapi rikuperimi të sulfatit të amonit.

2. Metodë sipas pretendimit 1, ku rrjedha e furnizimit përfshin të paktën litium dhe një ose më shumë nga bakri, hekuri, alumini, mangani, kobalti dhe nikeli.

3. Metodë sipas pretendimit 1 ose 2, ku metoda përfshin më tej hapin e: nënshtrimit të rrjedhës së furnizimit në një proces para-trajtimi, përpara hapat të nënshtrimit të rrjedhës së furnizimit në një shpëlarjeje me acid sulfurik.

4. Metodë sipas pretendimit 3, ku procesi i para-trajtitit përfshin një ose më shumë hapa trajtimi mekanik; ku një ose më shumë hapa trajtimi mekanik përfshijnë mundësisht një ose më shumë nga: një hap thërrmimi dhe një hap copëtimi.

5. Metodë sipas secilit prej pretendimeve 3 ose 4, ku procesi i para-trajtitit përfshin një ose më shumë hapa reduktimi të madhësisë.

6. Metodë sipas secilit prej pretendimeve 3 deri në 5, ku procesi i para-trajtitit përfshin një ose më shumë hapa përpunimi; ku një ose më shumë hapa të përpunimit përfshijnë mundësisht një ose më shumë nga një hap klasifikimi ajri, një hap klasifikimi magnetik dhe një hap pluskimi.

7. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku hapi i nënshtrimit të rrjedhës së ushqimit ndaj një shpëlarjeje me acid sulfurik kryhet në presion atmosferik.

8. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku hapi i nënshtrimit të rrjedhës së ushqimit ndaj një shpëlarjeje me acid sulfurik kryhet në temperaturë të lartë.

9. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku hapi i: nënshtrimit të rrjedhës së ushqimit ndaj një shpëlarjeje me acid sulfurik për të formuar një slurri që përfshin një tretësirë

shpëlarjeje të mbushur me kripëra metalike të tretshme dhe një mbetje të ngurtë, më konkretisht përfshin nënshtrimin e rrjedhës së ushqimit ndaj një shpëlarjeje me acid sulfurik në një ose më shumë reaktorë shpëlarjeje.

10. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku secili hap i nxjerrjes me tretës përfshin: kontaktin e tretësirës së mbushur me kullim me një nxjerrës për të nxjerrë një ose më shumë metale për të prodhuar një nxjerrës të ngarkuar që përmban një ose më shumë metale të nxjerra; ndarjen e nxjerrësit të ngarkuar nga tretësira e mbushur me kullim; dhe rikuperimin e metalit nga nxjerrësi i ngarkuar.

11. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku njëri prej hapave të veçantë të nxjerrjes me tretës është përshtatur për të rikuperuar manganin nga tretësira e mbushur me kullim.

12. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku njëri prej hapave të veçantë të nxjerrjes me tretës është përshtatur për të rikuperuar kobaltin nga tretësira e mbushur me kullim.

13. Metodë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku njëri prej hapave të veçantë të nxjerrjes me tretës është përshtatur për të rikuperuar njëkohësisht si kobaltin ashtu edhe manganin nga tretësira e mbushur me kullim.

14. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku njëri prej hapave të veçantë të nxjerrjes me tretës është përshtatur për të rikuperuar nikelin nga tretësira e mbushur me kullim.

15. Metodë sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku hapat e veçantë të nxjerrjes me tretës kryhen në mënyrë në mënyrë të njëpasnjëshme.

---

(11) **13107**

(97) EP3820449//14.05.2025

(96) 19736749.3//11.07.2019

(22) 25.06.2025

(21) [AL/P/2025/313](#)

(54) **KOMPOZIMI QË PËRMBAN NJË 7BETA-HIDROSIKOLESTEROL DHE NJË TRANSPORTUES LIPID, DHE PËRDORIMI I TIJ NË TRAJTIMIN E PATOLOGJIVE NEOPLASTIKE**

24.09.2025

(30) EP 18305933 11/07/2018


(71) Beta Innov/ 49 rue Rouelle, 75015 Paris / FR

(72) Marcel MERSEL/Villa Bellagio 1149 rue de la Croix Verte 34090 Montpellier / FR,  
Clovis RAKOTOARIVelo/Résidence Porte des consuls apt 45 20 rue de la nuit du 4 août 1789  
34070 Montpellier / FR

(74) Krenar Loloçi//

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Kompozimi që përfshin të paktën një derivat të 7β-hidroksikolesterolit dhe një transportues lipid, ku transportuesi lipid i sipërpërmendur përfshin një vaj ose një përzierje të vajrave, duke përjashtuar një transportues lipid të përbërë prej fshikëzave lipidike të formuara nga një ose më shumë shtres(a) lipide ose të përbërë prej fosfolipideve në formën jo-lipozomale, në të cilët derivati i 7β-hidroksikolesterolit korrespondon me (I)



në të cilën:

- A përfaqëson


një grup -C(O) R1 në të cilin R1 është një heterocikël i saturuar që përfshin 5 deri në 14 elemente dhe që inkludon 1 ose 2 heteroatome, të pazëvendësuar ose të zëvendësuar me të paktën një linear ose të degëzuar C1-C6 alkil ose një grup të zgjedhur nga OR, NRR', NHR dhe SR, ku R dhe R', në mënyrë të pavarur, përfaqësojnë hidrogjen, një C1-C12 linear ose të degëzuar, në mënyrë të preferuar C1-C6, alkil, ose një aril të pazëvendësuar;

ose një grup -(R2) n- në të cilin R2 është një mbetje amino acide e lidhur te fundi C-fundor i tij dhe n= 1 deri në 3, secili prej R2 që është identik ose ndryshe, në të cilin fundi N-fundor i amino acidit të sipërpërmendur mund të jetë i zëvendësuar me një grup -C(O) R3 në të cilin R3 është një grup C6-C14 arilalkil mono- ose policiklik; një grup C5-C14 heteroarilalkil mono- ose policiklik që mund të përfshijë një ose më shumë heteroatome, të cilët mund të jenë identik ose ndryshe; një grup C6-C14 arilalkiloksi mono- ose policiklik ose një grup C5-C14 heteroarilalkiloksi mono- ose policiklik që mund të përfshijë një ose më shumë heteroatome, të cilët mund të jenë identik ose ndryshe,

- B përfaqëson një grup -C(O) R<sub>4</sub>, në të cilin R<sub>4</sub> është një C<sub>1</sub>-C<sub>12</sub> linear ose i degëzuar, në mënyrë të preferuar C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub>, alkil, të pazëvendësuar ose të zëvendësuar me një grup të zgjedhur nga OR, NRR', NHR dhe SR, siç përcaktohet më lart; një grup aril, të pazëvendësuar ose të zëvendësuar me një grup të zgjedhur nga OR, NRR', NHR dhe SR, siç përcaktohet më lart; ose R<sub>4</sub> përfaqëson OR<sub>5</sub>, në të cilin R<sub>5</sub> është një C<sub>1</sub>-C<sub>12</sub> linear ose i degëzuar, në mënyrë të preferuar C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub>, alkil.
- 2. Kompozimi sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që ai është në një formë të përshtatshme për administrim me anë të rrugës orale.
- 3. Kompozimi sipas pretendimeve 1 ose 2 karakterizuar në atë që përbërja e formulës (I) është në tretësirë në transportuesin lipid të sipërpërmendur.
- 4. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 3, në të cilin transportuesi lipid i sipërpërmendur përfshin një vaj vegjetal ose një përzierje të vajrave vegjetal.
- 5. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 4, në të cilin transportuesi lipid i sipërpërmendur përfshin një vaj vegjetal i zgjedhur nga vaji i arganit, vaji i avokados, vaji i farave të linit, vaji i lulediellit, vaji i palmës, vaji i palmës së lakrës, vaji i kokosit, vaji i farave të rrushit, vaji i mustardës së zezë, vaji i farave të lulëkuqes, vaji i gjalpiti shea, vaji i bajames së ëmbël, vaji i sojes, vaji i kikirikut, vaji i farave të pambukut, vaji i susamit, vaji i ullirit, vaji i misrit, vaji i kakaos, vaji i kastorit, vaji i Moringës (ose vaji Ben) , vaji i farave të rapesë, vaji annatto, vaji i grurit, vaji i lulediellit, vaji i arrës, vaji i lajthisë, vaji i mushtit të rrepës ose përzierje të tyre.
- 6. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 5, në të cilin transportuesi lipid i sipërpërmendur është vaj argani.
- 7. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6, karakterizuar në atë që, në formulën (I) , A përfaqëson një grup -C(O) R<sub>1</sub> në të cilin R<sub>1</sub> është një heterocikël i saturuar që përfshin 5 elemente dhe që inkludon 2 atome oksigjen, të zëvendësuar me të paktën një C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil linear ose të degëzuar.
- 8. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 7, karakterizuar në atë që, në formulën (I) , B përfaqëson një grup -C(O) R<sub>4</sub> në të cilin R<sub>4</sub> është një C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil linear ose i degëzuar, ose R<sub>4</sub> përfaqëson OR<sub>5</sub>, në të cilin R<sub>5</sub> është një C<sub>1</sub>-C<sub>12</sub> linear ose i degëzuar, në mënyrë të preferuar C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub>, alkil.
- 9. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 8, karakterizuar në atë që, në formulën (I) , B përfaqëson një grup acil në të cilin grupi alkil është C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> ose një grup alkoksikarbonil në të cilin grupi alkil është C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub>.
- 10. Kompozimi sipas pretendimit 1 deri në 6, 8 ose 9, karakterizuar në atë që, në formulën (I) , A përfaqëson:
  - një grup -(R<sub>2</sub>) n- në të cilin R<sub>2</sub> është një mbetje amino acide dhe n = 2; ose
  - një grup -(R<sub>2</sub>) n- në të cilin R<sub>2</sub> është një mbetje amino acide, n= 2 dhe fundi N-fundor i amino acidit të sipërpërmendur është i zëvendësuar me një grup arilalkoksikarbonil, në veçanti benziloksikarbonil; ose
  - një radikal alanil të lidhur te një radikal glicinil, opsionalisht të zëvendësuar te fundi N-fundor i tij me një grup arilalkoksikarbonil, në veçanti benziloksikarbonil; ose
  - një radikal metionil të lidhur te një radikal glicinil, opsionalisht të zëvendësuar te fundi N-fundor i tij me një grup arilalkoksikarbonil, në veçanti benziloksikarbonil, dhe
  - B është siç përcaktohet në çdo njërin prej pretendimeve 1, 8 ose 9.
- 11. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 10, në të cilin derivati i 7β-hidroksikolesterolit është zgjedhur nga përbërjet e formulës (I) në të cilat:
  - A është një grup 3-benziloksikarbonil-glicinil-alanil dhe B është një grup tert-butoksikarbonil, ose

- A është një grup 3-benziloksikarbonil-glicinil-alanil dhe B është një grup acetyl, ose
- A është një grup -C(O) R1 në të cilin R1 është një grup 2,2-dimetil-1,3-dioksolan dhe B është një grup tert-butoksikarbonil.

12. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9 ose 11, në të cilin derivati i 7 $\beta$ -hidroksikolesterolit është një përbërje e formulës (I) në të cilën A është një grup -C(O) R1 në të cilin R1 është një grup 2,2-dimetil-1,3-dioksolan dhe B është një grup acetyl, i formulës



13. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 12, në të cilin përmbajtja e përbërjes e formulës (I) është nga 0.1 deri në 3.5% (w/v) e vëllimit total të kompozimit.

14. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 13, karakterizuar në atë që përmbajtja e përbërjes e formulës (I) është nga 1 deri në 35 mg/ml, në mënyrë të preferuar 30 mg/ml.

15. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 14, karakterizuar në atë që përmbajtja e transportuesit lipid është nga 90 deri në 99% (v/v) e vëllimit total të kompozimit.

16. Kompozimi farmaceutik që përfshin një kompozim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 15.

17. Kompozimi farmaceutik sipas pretendimit 16, karakterizuar në atë që ai është në një formë të përshtatshme për administrim me anë të rrugës orale.

18. Metoda për përgatitjen e një kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 13, që përfshin hapat e mëposhtëm: - përgatitjen e një përzierje që përmban derivatin e 7 $\beta$ -hidroksikolesterolit të formulës (I) siç përcaktohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 ose 9 deri në 12, një transportues lipid dhe një bashkë-tretës, - opsionalisht shtimin e një antioksidanti dhe - nëse aplikohet, avullimin e bashkë-tretësit.

19. Metoda sipas pretendimit 18, ku transportuesi lipid është siç përcaktohet në çdo njërin prej pretendimeve 4 deri në 6.

20. Kompozimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 17, për përdorim në trajtimin e një patologjie neoplastike ose një hemopatie malinje.

21. Kompozimi për përdorim sipas pretendimit 20, në të cilin patologjia neoplastike është glioblastoma multiforme.

(11) **13117**

(97) EP4301131//07.05.2025

(96) 22709698.9//01.03.2022

(22) 28.06.2025

(21) [AL/P/2025/321](#)

(54) **NJË PAJISJE PËR DEGAZIM DHE NJË SISTEM AKUAKULTURE ME NJË PAJISJE TË TILLË PËR DEGAZIM**

07.10.2025

(30) DK PA202100222 03/03/2021

(71) TD Holt Holding ApS/ Tågelundvej 5 6040 Egtved / DK,

(72) HOLT, Thomas/6040 Egtved / DK

(74) Aleksandra Meçaj//Myslym Shyri; Nd. 0; ; ; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË.

(57) 1. Pajisje degazimi (100) e përshtatur për çlirimin e dioksidit të karbonit nga një rrjedhë uji, pajisja në fjalë (100) përfshin: - një strukturë tubulare (110) që përfshin një hyrje uji (112) dhe një dalje uji (114) ; - një bosht të zgjatur (120) që mban një numër telesh (130) të përdredhura rreth një boshti gjatësor qendror të boshtit të lartpërmendur (120) ; - një varëse (140) të përshtatur për të mbështetur boshtin e lartpërmendur (120) brenda strukturës tubulare të lartpërmendur (110) ; ku boshti i lartpërmendur (120) është i lidhur në mënyrë rrotulluese me varësen e lartpërmendur (140) ; ku secili prej teheve të lartpërmendura (130) përfshin një pjesë qendrore (132) dhe dy pjesë anësore (134) , secila mbështjell pjesën qendrore të lartpërmendur (132) ; ku një pjesë kryesore e pjesës qendrore (132) është në thelb pa dhëmbëzime, dhe ku pjesët anësore (134) janë të dhëmbëzuara me dhëmbëzime të shumëfishta (136) , dhëmbëzimet në fjalë (136) mundësisht shpërndahen në mënyrë të barabartë mbi një pjesë kryesore të pjesëve anësore (134) , karakterizuar në atë që boshti në fjalë (120) është i pozicionuar brenda strukturës tubulare (110) midis hyrjes (112) dhe daljes (114) të strukturës tubulare në fjalë (110) .

2. Pajisja e degazimit (100) sipas pretendimit 1, ku dhëmbëzimet (136) secila ka një diametër brenda intervalit 2-20 mm.

3. Pajisja e degazimit (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-2, ku struktura tubulare (110) përfshin mure të dhëmbëzuara, dhëmbëzimet në fjalë shpërndahen në mënyrë të barabartë mbi një pjesë kryesore të strukturës tubulare (110) , dhe kanë një diametër brenda intervalit 2-20 mm.

4. Pajisja e degazimit (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-3, ku secili teh (130) përfshin një rrënjë tehu dhe një majë tehu; ku rrënja e tehut është e fiksuar në boshtin e lartpërmendur (110) dhe maja e tehut është e fiksuar në një element tubular (150) të përshtatur për t'u rrotulluar lirisht brenda strukturës tubulare (110) .

5. Pajisja e degazimit (100) sipas pretendimit 4, ku elementi tubular (150) përfshin mure të dhëmbëzuara, dhëmbëzimet në fjalë mundësisht të shpërndara në mënyrë të barabartë mbi një pjesë kryesore të elementit tubular (150) , dhe mundësisht të kenë një diametër brenda intervalit 2-20 mm.

6. Pajisja e degazimit (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-5, ku hyrja e ujit (112) është e përshtatur për të drejtuar ujin në pjesën qendrore (132) të secilit prej teheve të lartpërmendura (130) .

7. Pajisja e degazimit (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-6, ku varësja e lartpërmendur (140) është konfiguruar për të përcaktuar një numër hyrjesh uji (112) , dhe ku çdo hyrje uji (112) është përshtatur për të drejtuar ujin në një teh përkatës (130) .

8. Një sistem akuakulture që përfshin: - një ose më shumë rezervuarë ose pellgje të mbushura me

ujë të përshtatura për mbajtjen e peshqve dhe/ose specieve të tjera të jetës ujore; - një ose më shumë hyrje uji që çojnë ujin në rezervuarët ose pellgjet e lartpërmendura; - një ose më shumë dalje uji që çojnë ujin jashtë rezervuarëve ose pellgjeve të lartpërmendura; dhe - një ose më shumë pajisje degazimi (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-7.

9. Sistemi i akuakulturës sipas pretendimit 8, ku një ose më shumë pajisje degazimi (100) janë të pozicionuara në një rezervuar uji në komunikim uji me një ose më shumë dalje uji.

10. Përdorimi i një ose më shumë pajisjeve të degazimit (100) sipas secilit prej pretendimeve 1-7 për heqjen e dioksidit të karbonit nga uji i një sistemi akuakulture, mundësisht një sistem akuakulture me riqarkullim.

---

(11) **13087**

(97) EP3817751//18.06.2025

(96) 19830950.2//01.07.2019

(22) 28.06.2025

(21) [AL/P/2025/322](#)

(54) **FORMULIMET E TIOSULFATIT TË NATRIUMIT ANHIDRIK**

18.09.2025

(30) US 201862693503 P 03/07/2018 ,US 201862693502 P 03/07/2018

(71) Fennec Pharmaceuticals, Inc./ 68 TW Alexander Drive Research Triangle Park NC 27709 / US

(72) SMITH, Alexander/Apex NC27502 / US

(74) Aleksandra Meçaj//Myslym Shyri; Nd. 0; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË.

(57) 1. Një përbërje farmaceutike që përmban  $0.5 \pm 10\%$  M të tiosulfatit të natriumit anhidrik uxor,  $0.004 \pm 10\%$  M të acidit borik ose një kripe të tij, pH  $8.6 \pm 0.8$ , dhe ujë.

2. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1 ku përbërja përfshin 0.5 M të tiosulfatit të natriumit anhidrik uxor, 0.004 M të acidit borik ose një kripe të tij, pH  $8.6 \pm 0.8$ , dhe ujë.

3. Përbërje farmaceutike që përmban  $40 \pm 10\%$  mg/mL deri në  $160 \pm 10\%$  mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor;  $0.25 \pm 10\%$  mg/mL zbutës borat, pH 6 deri në 9, dhe ujë.

4. Përbërja farmaceutike e pretendimit 3, ku përbërja përmban  $60 \pm 10\%$  mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor.

5. Përbërja farmaceutike e pretendimit 3, ku përbërja përfshin  $80 \pm 10\%$  mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor.

6. Përbërja farmaceutike e pretendimit 3, ku përbërja përfshin  $100 \pm 10\%$  mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor.

7. Përbërja farmaceutike e pretendimit 3 ku përbërja përfshin 40 mg/mL deri në 160 mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor; 0.25 mg/mL tampon borati, pH 6 deri në 9, dhe ujë.

8. Përbërja farmaceutike e pretendimit 7 ku përbërja përfshin 80 mg/mL tiosulfat natriumi anhidrik uxor.

9. Përbërje farmaceutike që përfshin rreth 4% në peshë deri në rreth 16% në peshë tiosulfat natriumi anhidrik uxor; rreth 0.023% në peshë zbutës borati me pH 6 deri në 9, dhe ujë, ku termi 'rreth' i referohet çdo vlere duke përfshirë si numrat e plotë ashtu edhe përbërësit fraksionalë që janë brenda një ndryshimi deri në  $\pm 10\%$  të vlerës së modifikuar nga termi 'rreth'.

10. Përbërja farmaceutike e pretendimit 9, ku përbërja përfshin rreth 6% në peshë tiosulfat natriumi anhidrik uxor, ku termi 'rreth' i referohet çdo vlere që përfshin si numra të plotë ashtu edhe përbërës fraksionalë që janë brenda një ndryshimi deri në  $\pm 10\%$  të vlerës së modifikuar nga termi 'rreth'.

11. Përbërja farmaceutike e pretendimit 9, ku përbërja përfshin rreth 8% në peshë tiosulfat natriumi anhidrik uxor, ku termi 'rreth' i referohet çdo vlere që përfshin si numra të plotë ashtu edhe përbërës fraksionalë që janë brenda një ndryshimi deri në  $\pm 10\%$  të vlerës së modifikuar nga termi 'rreth'.

12. Përbërja farmaceutike e pretendimit 9, ku përbërja përfshin rreth 10% në peshë tiosulfat natriumi anhidrik uxor, ku termi 'rreth' i referohet çdo vlere që përfshin si numra të plotë ashtu edhe përbërës fraksionalë që janë brenda një ndryshimi deri në  $\pm 10\%$  të vlerës së modifikuar nga termi 'rreth'.

13. Përbërja farmaceutike e pretendimit 9 ku përbërja përfshin 4% në peshë deri në 16% në peshë tiosulfat natriumi anhidrik uxor; 0.023% në peshë zbutës borati me pH 6 deri në 9 dhe ujë.

14. Përbërja farmaceutike e pretendimit 13 ku përbërja përfshin 8% në peshë tiosulfat natriumi

anhidrik ujqor.

15. Përbërje farmaceutike sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 14 për përdorim në uljen e ototoksicitetit tek pacientët që marrin një kimioterapeutik me bazë platini.

---

(11) **13118**

(97) EP4036119//02.07.2025

(96) 22152178.4//06.05.2013

(22) 18.07.2025

(21) [AL/P/2025/352](#)

(54) **ANTITRUPAT KUNDËR CLAUDIN 18.2 TË DOBISHËM NË DIAGNOSTIKIMIN E KANCERIT**

07.10.2025

(30) PCT/EP PCT/EP2012/001991 09/05/2012

(71) Astellas Pharma Inc./ 5-1, Nihonbashi-Honcho 2-Chome Chuo-ku  
Tokyo 103-8411 / JP,

TRON - Translationale Onkologie an der Universitätsmedizin der Johannes Gutenberg-Universität Mainz gemeinnützige GmbH/ Freiligrathstrasse 12 55131 Mainz / DE

(72) Ugur SAHIN/55116 Mainz / DE,

Özlem TÜRECI/55116 Mainz / DE,

Rita MITNACHT-KRAUS/61169 Friedberg / DE,

Stefan WÖLL/55299 Nackenheim / DE,

(74) Krenar Loloçi//ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një kompozim diagnostikues që përfshin një antitrup që lidhet te Claudin 18 variant bashkimi 2 (CLDN18.2) , ose një fragment i tij që lidhet me-antigjenin, ku antitrupi përfshin

(A)

një zinxhir i rëndë antitrupi që përfshin:

një sekuencë CDR1 sipas SEQ ID NO: 8,

një sekuencë CDR2 sipas SEQ ID NO: 9, dhe

një sekuencë CDR3 sipas SEQ ID NO: 10,

dhe

një zinxhir i lehtë antitrupi që përfshin:

një sekuencë CDR1 sipas SEQ ID NO: 12,

një sekuencë CDR2 sipas SEQ ID NO: 13, dhe

një sekuencë CDR3 sipas SEQ ID NO: 14,

ose

(B)

një zinxhir i rëndë antitrupi që përfshin:

një sekuencë CDR1 sipas SEQ ID NO: 16,

një sekuencë CDR2 sipas SEQ ID NO: 17, dhe

një sekuencë CDR3 sipas SEQ ID NO: 18,

dhe

një zinxhir i lehtë antitrupi që përfshin:

një sekuencë CDR1 sipas SEQ ID NO: 20,

një sekuencë CDR2 sipas SEQ ID NO: 21, dhe

një sekuencë CDR3 sipas SEQ ID NO: 22.

2. Kompozimi diagnostikues i pretendimit 1, ku CLDN18.2 i sipërpërmendur është i lidhur me membranën e sipërfaqes qelizore CLDN18.2.
3. Kompozimi diagnostikues i pretendimit 1 ose 2, ku CLDN18.2 i sipërpërmendur është i pranishëm në qelizat kancerogjene.
4. Kompozimi diagnostikues i pretendimit 3, ku qelizat kancerogjene janë qeliza kancerogjene që shprehin CLDN18.2.
5. Kompozimi diagnostikues i pretendimit 4, ku qelizat kancerogjene të sipërpërmendura janë zgjedhur nga grupi që përbëhet nga qelizat kancerogjene të stomakut, ezofagut, pankreasit, mushkërive, vezoreve, zorrës së trashë, mëlçisë, kokës, qafës dhe fshikëzës së tëmthit.
6. Kompozimi diagnostikues i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku antitrupi është një antitrop monoklonal, kimerik, njerëzor ose i humanizuar.
7. Kompozimi diagnostikues i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku antitrupi përfshin rajonin variabël të SEQ ID NO: 7, 11, 15 ose 19.
8. Kompozimi diagnostikues i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku antitrupi përfshin sekuencën e aminoacideve të SEQ ID NO: 7, 11, 15 ose 19.
9. Një kompozim diagnostikues që përfshin një konjugat antitropi, konjugati i sipërpërmendur që përfshin një antitrop ose fragment që lidhet me antigjenin siç përcaktohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 8 të shoqëruar me të paktën një etiketë të dallueshme.
10. Një metodë për zbulimin e CLDN18.2 ose përcaktimin e sasisë së CLDN18.2 në një mostër që përfshin hapat e:
  - (i) kontaktimi i një mostre me përbërjen e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9 dhe
  - (ii) zbulimin e formimit të një kompleksi ose përcaktimin e sasisë së një kompleksi ndërmjet antitropit, fragmentit që lidh antigjenin ose konjugatit dhe CLDN18.2.
- 11.. Një metodë për përcaktimin nëse qelizat shprehin CLDN18.2 që përfshin hapat e:
  - (i) kontaktimi i një mostre qelizore me përbërjen e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9 dhe
  - (ii) zbulimin e formimit të një kompleksi midis antitropit, fragmentit që lidh antigjenin ose konjugatit dhe CLDN18.2 të shprehur nga qelizat në mostrën e sipërpërmendur
- 12.Një metodë për diagnostikimin, zbulimin ose monitorimin e kancerit, që përfshin hapat e:
  - (i) kontaktimi i një mostre biologjike me përbërjen e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9 dhe
  - (ii) zbulimin e formimit të një kompleksi dhe/ose përcaktimin e sasisë së një kompleksi midis antitropit, fragmentit që lidh antigjenin ose konjugatit dhe CLDN18.2, ku kanceri i sipërpërmendur karakterizohet nga qeliza kancerogjene që shprehin CLDN18.2.
- 13.Një metodë për të përcaktuar nëse një kancer është i trajtueshëm nga një terapi kundër kancerit që synon CLDN18.2, që përfshin hapat e:
  - (i) kontaktimi i një mostre që përmban qeliza kancerogjene me përbërjen e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9 dhe
  - (ii) zbulimin e formimit të një kompleksi midis antitropit, fragmentit që lidhet me antigjenin ose konjugatit dhe CLDN18.2,
 ku kanceri i sipërpërmendur karakterizohet nga qelizat kancerogjene që shprehin CLDN18.2.
14. Një kit testimi për diagnostikimin e një sëmundjeje që përfshin qelizat që shprehin CLDN18.2 i cili përfshin antitropin ose fragmentin që lidh antigjenin të përcaktuar në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 8 ose konjugatin e antitropit të përcaktuar në pretendimin 9.
15. Përbërja diagnostikuese e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9, metoda e çdo njërit prej pretendimeve 10 deri në 13 ose kiti i pretendimit 14, ku CLDN18.2 i sipërpërmendur përfshin sekuencën e aminoacideve sipas SEQ ID NO: 2 të listës së sekuencave.

16. Metoda e çdo njërit prej pretendimeve 10 deri në 13, ku metoda është një analizë imunohistokimike dhe përqendrimi i antitropave është deri në 0.5µg/ml ose deri në 0.2µg/ml dhe/ose ku mostra përfshin ind të ngulitur në parafinë të fiksuar me paraformaldehidë.
17. Një acid nukleik që përfshin një sekuençë acidi nukleik që kodon zinxhirin e rëndë të antitropit dhe/ose zinxhirin e lehtë të antitropit, të antitropit të përcaktuar nga çdo njëri prej pretendimeve 1 deri në 8 ose të një fragmenti që lidh-antigjenin të antitropi i sipërpërmendur.
18. Një vektor që përmban acidin nukleik të pretendimit 17.
19. Një qelizë pritëse që përmban acidin nukleik të pretendimit 17 ose vektorin e pretendimit 18.
20. Një hibridomë e aftë të prodhojë antitropin e përcaktuar nga çdo njëri prej pretendimeve 1 deri në 8.
21. Një metodë për shprehjen e një antitropi, që përfshin hapin e:
- (a) marrjen e qelizës pritëse të pretendimit 19; dhe
  - (b) izolimi nga qeliza pritëse (a) e një antitropi.
22. Një antitrop i marrë nga qeliza pritëse e pretendimit 19 ose i marrë nga metoda e pretendimit 21.
23. Një antitrop siç përcaktohet nga çdo njëri prej pretendimeve 1 deri në 8 ose një fragment i tij që lidh antigjenin, ku antitropi i sipërpërmendur është një antitrop monoklonal.
-

(11) 13132

(97) EP4161929//30.04.2025

(96) 21732212.2//07.06.2021

(22) 21.07.2025

(21) [AL/P/2025/355](#)

(54) 1-(5-(2-CIANOPIRIDIN-4-IL)OKSAZOL-2-KARBONIL)-4-METILHEKSAHIDROPIROLO[3,4-B]PIROLE-5(1H)-KARBONITRIL SI FRENUES USP30 PËR PËRDORIM NË MJEKIMIN E MOSFUNKSIONIMIT MITOKONDRIAL, KANCERIT DHE FIBROZËS

09.10.2025

(30) GB 202008598 08/06/2020 ,GB 202016758 22/10/2020

(71) Mission Therapeutics Limited/ Babraham Hall, Babraham, Cambridge CB22 3AT / GB, //

(72) LUCKHURST, Christopher Andrew/Cambridge CB22 3AT / GB,


KEMP, Mark Ian/Cambridge CB22 3AT / GB,

THOMPSON, Paul William/Cambridge CB22 3AT / GB,

STOCKLEY, Martin Lee/Cambridge CB22 3AT / GB.


(74) Fatos Dega//NIKOLLA TUPE; Nd. 2; H. 4; Ap. 30; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një përbërës me formulë (I) :




ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij.

2. Përbërësi sipas pretendimit 1, me formulë (IA) :



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij.

3. Përbërësi sipas pretendimit 1, me formulë (IB) :



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij.

4. Përbërësi sipas pretendimit 1 që është: (3aR,4R,6aR) -1-(5-(2-cianopiridin-4-il) oksazol-2-karbonil) -4-metilheksahidropirrol[3,4-b]pirrol-5(1H) -karbonitril; ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij.

5. Një përbërës sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri në 4, ose një kripë farmaceutikisht e

pranueshme e tij, për përdorim si ilaç.

6. Një përbërës sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri në 4, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij, për përdorim në mjekimin ose parandalimin e një gjendjeje që përfshin mosfunksionimin mitokondrial, një kancer ose fibrozë.

7. Një përbërës për përdorim sipas pretendimit 6, ku gjendja që përfshin mosfunksionimin mitokondrial përzgjidhet nga një çrregullim i SNQ-së; sëmundja neurodegjenerative; sëmundja e Parkinsonit; sëmundja e Alzheimerit; skleroza laterale amiotrofike; sëmundja e Huntingtonit; ishemia; goditja në tru; demenca me trupa Lewy; demenca frontotemporale; skleroza multiple; encefalopatia mitokondriale, acidoza laktike dhe sindroma e episodeve të ngjashme me goditjen në tru; diabeti dhe shurdhimi i trashëguar nga nëna; neuropatia optike e trashëguar e Leberit; neuropatia, ataksia, retinit pigmentoza - sindroma Leigh e trashëguar nga nëna; sëmundja e Danon; diabeti; nefropatia diabetike; çrregullimet metabolike; dështimi i zemrës; sëmundja ishemike e zemrës që çon në infarkt miokardi; sëmundja psikiatrike, skizofrenia; mungesa e sulfatazës së shumëfishtë; mukolipidoza II; mukolipidoza III; mukolipidoza IV; GML-gangliosidoza; ceroid-lipofushinoza neuronale; sëmundja e Alpers; sindroma e Barth; defektet e beta-oksidimit; mungesa e karnitinë-acil-karnitinës; mungesa e karnitinës; sindroma e mungesës së kreatinës; mungesa e ko-enzimës Q10; mangësia e kompleksit I; mangësia e kompleksit II; mangësia e kompleksit III; mangësia e kompleksit IV; mangësia e kompleksit V; mangësia e COX; sindroma e oftalmoplegjisë kronike progresive të jashtme; mangësia e CPT I; mangësia e CPT II; aciduria glutarike tipi II; sindroma Kearns-Sayre; acidoza laktike; mangësia e dehidrogjenazës acil-CoA me zinxhir të gjatë; sëmundja ose sindroma e Leigh; sindroma e Leigh varianti francez-kanadez; kardiomiopatia letale infantile; sëmundja Luft; mangësia e dehidrogjenazës acil-CoA me zinxhir të mesëm; epilepsia mioklonike dhe sindroma e fibrave të kuqe të grisura; citopatia mitokondriale; sindroma e ataksisë recesive mitokondriale; sindroma e pakësimit të ADN-së mitokondriale; çrregullim dhe encefalopati mioneurogastrointestinale; sindroma Pearson; mangësia e dehidrogjenazës së piruvatit; mangësia e karboksilazës së piruvatit; mutacionet POLG; mangësia e dehidrogjenazës 3-hidroksiacyl-CoA me zinxhir të mesëm/të shkurtër; mangësia e dehidrogjenazës acil-CoA me zinxhir shumë të gjatë; çrregullimet peroksisomale; acidemia metilmalonike; mangësia e kinazës mevalonate; rënia e varur nga mosha në funksionin njohës dhe fuqinë muskulore; dhe dëmtimi njohës i shoqëruar me të gjitha çrregullimet neurodegjenerative dhe neuropsikiatrike.

8. Një përbërës për përdorim sipas pretendimit 7, ku sëmundja neurodegjenerative përzgjidhet nga sëmundja e Parkinsonit, sëmundja e Alzheimerit, skleroza laterale amiotrofike, sëmundja e Huntingtonit, ishemia, goditja në tru, demenca me trupa Lewy, atrofia e sistemit të shumëfishtë, paraliza supranukleare progresive, degjenerimi kortikobazal, demenca frontotemporale; dhe sëmundja e Parkinsonit e lidhur me mutacionet në  $\alpha$ -sinukleinë, parkinë, PINK1, GBA dhe LRRK2, dhe sëmundja autozomale recesive juvenile e Parkinsonit ose sëmundja e Parkinsonit me fillim të hershëm (EOPD), ku parkina ose PINK1 është e mutuar, e cunguar ose e fshirë.

